

I.T.E. ENGINEERING SH.P.K.

Shenime mbi pasqyrat financiare per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2020

(Vlerat në Leke)

1. Të Përgjithshme

"ITE ENGINEERING" SH.P.K (ne vijim "Shoqeria") është themeluar si një shoqëri me përgjegjësi të kufizuara më datë 07/03/2016 në përputhje me Ligjin nr.9901, datë 14.04.2008 "Mbi Shoqëritë tregtare" dhe është regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit me numrin e identifikimit L615300011.

Selia ligjore e shoqërisë është në adresën: Rruga dytësore, autostrada Tiranë- Durrës, km 5, Tiranë.

Shoqeria ka celur nje dege ne Republikën e Kosoves me date 06/04/2020 me nr. regjistri 811411785 dhe adrese ne: Prishtinë, Rruga Garibaldi, H9/A-1

Kapitali i nënshkruar i shoqërisë është 1.000.000,00 Lek. Ortak i vetem i shoqërisë është "ITE GRUP" SH.P.K, zotërues i 100% të kapitalit të shoqërisë.

Shoqeria ka për objekt aktivitetin e projektimit dhe zbatimit te projekteve, dhenien e konsulences, asistences, teknike dhe kryerjen e shërbimeve ne lidhje me veprimtarite ne fushen elektrike, elektronike dhe te telekomunikacionit, etj.

2. Deklarata e Përputhshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Ligjin nr. 25/2018 datë 10 Maj 2018 " Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare".

3. Përmbledhëse e politikave te rëndësishme kontabël

(a) Të përgjithshme

Këto pasqyra financiare janë përgatitur bazuar ne parimin e kostos historike dhe në përputhje me Standartet Shqiptare të Kontabilitetit. Këto pasqyra financiare janë paraqitur në LEK Shqiptar ("LEK") që është monedha raportuese e shoqërisë.

(b) Të ardhurat

Në rastet kur rezultati i një transaksioni që përfshin ofrimin e shërbimeve mund të matet me besueshmeri, të ardhurat me këtë transaksion njihen në varësi të fazës së përfundimit të shërbimit në fund të periudhës së raportimit. Rezultati i një transaksioni mund të matet me besueshmëri kur plotësohen të gjitha kushtet e mëposhtme:

- i. Shuma e të ardhurave mund të matet me besueshmeri;
- ii. Arkëtimi i pagesës nga kryerja e shërbimit është i mundur
- iii. Volumi i kryerjes së shërbimit në datën e bilancit mund të matet me besueshmeri
- iv. Shpenzimet e bëra për shërbimin në datën e bilancit, si dhe ato që do te bëhen për përfundimin e tij mund të maten me besueshmëri

(c) Vleresimi i likuiditeteve

I.T.E. ENGINEERING SH.P.K.

Shenime mbi pasqyrat financiare per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2020

(Vlerat në Leke)

Gjendjet e likuiditeteve perfshijne gjendjen e parave ne arke dhe ne llogarite rrjedhese ne banke ne leke dhe ne monedha te huaja.

(d) Monedhat e huaja

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në LEK me kursin e këmbimit në datën që bëhen transaksionet. Të ardhurat dhe humbjet nga kurset e këmbimit, që vijnë për shkak të shlyerjeve të këtyre transaksioneve dhe të rivlersimit të aktiveve dhe detyrimeve monetare të shprehura në monedhë të huaj në fund të periudhës, njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kurset zyrtare te këmbimit sipas bankës së shqipërise të përdorura për përgatitjen e pasqyrave financiare (lek kundrejt monedhës perkatëse) për monedhat kryesore më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 janë si më poshtë:

	2020	2019
EUR	123.70	121.77
USD	100.84	108.64

(e) Aktivet afatgjata materiale**i. Njohja dhe matja**

Aktivët afatgjata materiale, maten me kosto duke zbritur amortizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga zhvlersimi. Kostot përfshijnë shpenzimet që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me blerjen e aktivit. Kosto e aktiveve të ndërtuara nga vetë shoqëria përfshin koston e materialeve dhe punës direkte që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me sjelljen e aktivit në gjëndje pune për qëllimin e caktuar, kostot e cmontimit dhe lëvizjen e aktiveve të ndryshme dhe kthimin e vendodhjes së tyre ne gjëndjen e mëparshme.

Në rastet kur pjesë të një aktivit afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato stabilizohen si zëra te ndryshëm(komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

ii. Kostot në vijim

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

iii. Amortizimi

Amortizimi njihet ne pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, sipas legjislacionit shqiptar duke përdorur metodën lineare të amortizimit. Toka dhe aktivet në proces nuk amortizohen. Normat e amortizimit te zbatuara sipas kategorive te aktiveve kryesore janë si më poshtë:

Ndërtesa	5
Mjete transporti	20
Instrumenta dhe vegla pune	20
Makineri dhe pajisje pune	20
Mobilje dhe Orendi	20

I.T.E. ENGINEERING SH.P.K.

Shenime mbi pasqyrat financiare per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2020

(Vlerat në Leke)

Pajisje informative

25

(f) Tatimi mbi fitimin

Shpenzimi për tatimin aktual është bazuar në shumën e tatimit të pritshëm për tu paguar llogaritur sipas legjislacionit Shqiptar si dhe përcaktimeve në rregullat bazë kontabël në Shqipëri duke përdorur normën e tatimit të zbatueshëm në datën e hartimit të Pasqyrave si dhe cdo rregullim për tatim fitimin e pagueshëm në lidhje me vitet e mëparshme. Përqindja e tatimit në fuqi gjatë vitit 2020 ishte në masën 15%.

(g) Llogarite e arketueshme

Llogaritë e arkëtueshme paraqiten me vlerën neto të realizueshme, që është kosto minus provigjionin për llogaritë e dyshimta.

(h) Mjetet monetare

Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre përfshijnë paratë në dorë, depozitat në banka, investimet afatshkurtra me likuiditet të lartë dhe afat maturimi deri në tre muaj, që janë lehtësisht të konvertueshme në një shumë të njohur mjeteesh monetare dhe nuk janë subjekt i riskut të ndryshimit të vlerës së drejtë.

(i) Furnitore dhe detyrime të tjera

Furnitorët dhe detyrimet e tjera paraqiten me kosto.

(j) Krahasueshmëria

Informacioni krahasues paraqitet në mënyrë të vazhdueshme, duke aplikuar politikat kontabel të Shoqërise dhe duke u bazuar në modelin e pasqyrave financiare sipas sistemit kontabël Shqiptar.

4. Mjetet monetare

Mjetet monetare më 31 Dhjetor 2020 dhe 2019 janë të përbëra si më poshtë:

	<u>31/12/2020</u>	<u>31/12/2019</u>
Mjete monetare ne banke		
Banka Eur	806,842	199,777
Banka Leke	1,683,831	225,955
	<u>2,490,673</u>	<u>425,732</u>

I.T.E. ENGINEERING SH.P.K.

Shenime mbi pasqyrat financiare per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2020

(Vlerat në Leke)

Mjete monetare ne arke:

Arka Leke	136,336	166,492
	136,336	284,286

Totali	2,627,009	2,914,969
---------------	------------------	------------------

5. Kliente per mallra, produkte e sherbime

Llogaritë e arkëtueshme përfaqësojnë detyrime të paarkëtuara nga klientët ne datën e mbylljes se Pasqyrave Financiare. Llogaritë e arkëtueshme më 31 Dhjetor 2020 dhe 2019 janë të përbëra si më poshtë:

	31/12/2020	31/12/2019
Kliente per arketim	321,403,141	215,722,369
Totali	321,403,141	215,722,369

6. Te drejta te tjera te arketueshme

Detyrimet tatimore më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 paraqiten si më poshtë:

	31/12/2020	31/12/2019
Tatim fitimi	777,286	-
Tatim mbi vleren e shtuar (TVSH)	2,827,306	-
Takse doganore	3,549	-
Totali	3,608,141	-

7. Shpenzime te shtyra

Gjendja e shpenzimeve te shtyra me 31 dhjetor 2020 dhe 2019 paraqiten si me poshte:

	31/12/2020	31/12/2019
Paradhenie per blerje	29,974,410	2,462,578
Totali	29,974,410	2,462,578

I.T.E. ENGINEERING SH.P.K.

Shenime mbi pasqyrat financiare per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2020

(Vlerat në Leke)

8. Aktive afatgjata materiale

Vlera historike	Makineri dhe pajisje pune	Instrumente dhe vegla	Mjete Transporti	Mobilje dhe pajisje zyre	Pajisje informative	Total
Më 1 Janar 2020	957,697.58	3,042,131.55	9,426,894.26	402,031.50	2,586,512.09	16,415,266.98
Shtesa	391,179.33	937,177.61	3,530,908	61,915	489,466.13	5,410,646.07
Pakësime	-	128,946.54	1,717,000			1,845,946.54
Më 31 Dhjetor 2020	1,348,876.91	3,850,362.62	11,240,802.26	463,946.5	3,075,978.22	19,979,966.51
Amortizimi i akumuluar						
Më 1 Janar 2020	229,950.40	800,562.06	2,030,119.51	136,906.27	559,568.11	3,757,106.35
Shpenzimi i vitit	154,081.99	508,990.45	836,548.82	58,215.73	555,956.68	2,113,793.67
Më 31 Dhjetor 2020	384,032.39	1,309,552.51	2,866,668.33	195,122	1,115,524.79	5,870,900.02
Vlera kontabël, neto						
Më 1 Janar 2020	727,747.18	2,241,569.49	7,396,774.75	265,125.23	2,026,943.98	12,658,160.63
Më 31 Dhjetor 2020	964,844.52	2,540,810.11	8,374,133.93	268,824.5	1,960,453.43	14,109,066.49

I.T.E ENGINEERING SH.P.K*(Vlerat në Lekë)***9. Palët e lidhura**

Një palë e lidhur është një palë, e cila kontrollon, kontrollohet ose është nën një kontroll të përbashkët me njësinë tregtare; ka një interes mbi njësinë që i jep influencë të rëndësishme mbi entitetin; ose ka një kontroll të lidhur mbi entitetin; është ortak në shoqëri; është një sipërmarrje e përbashkët në të cilën entiteti është sipërmarrës; ose është një anëtar i personelit drejtues të entitetit, ose i familjarëve të afërm të tij. Ky zë në këto pasqyra paraqet financime kundrejt deges së shoqërisë në Kosovë. Pasqyrat financiare të deges së shoqërisë në Kosovë nuk janë mbyllur ende në datën e bilancit të ITE Engineering shpk.

	<u>31/12/2020</u>	<u>31/12/2019</u>
ITE Engineering - Dega në Kosovë	5,619,699	-
Totali	<u>5,619,699</u>	<u>-</u>

10. Detyrime Afatshkurtra ndaj institucioneve të kredisë:

Detyrime afatshkurta ndaj institucioneve të kredisë me 31 Dhjetor 2020 dhe 2019 janë të përbëra si më poshtë:

	<u>31/12/2020</u>	<u>31/12/2019</u>
Detyrime ndaj institucioneve të kredisë	18,200,847	-
Totali	<u>18,200,847</u>	<u>-</u>

11. Arketime në avance për porosi

Gjendja e arketimeve në avance për porosi me 31 dhjetor 2020 dhe 2019 paraqiten si më poshtë:

	<u>31/12/2020</u>	<u>31/12/2019</u>
Arketime në avance për porosi	72,191,427	32,914,233
Totali	<u>72,191,427</u>	<u>32,914,233</u>

12. Llogari të pagueshme

Në këtë zë janë paraqitur detyrimet e palikuiduara ndaj furnitorëve dhe punonjesve. Llogaritë e pagueshme më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 paraqiten si më poshtë:

	<u>31/12/2020</u>	<u>31/12/2019</u>
Furnitore dhe detyrime për të paguar	196,315,519	125,841,555

I.T.E ENGINEERING SH.P.K*(Vlerat në Lekë)*

Totali	195,315,519	125,841,555
---------------	--------------------	--------------------

13. Llogari të pagueshme per punonjesit

	31/12/2020	31/12/2019
Pagat e punonjesve	2,850,469	2,586,992
Sigurime shoqerore & shendetesore	925,688	835,104
Totali	3,776,157	3,422,096

14. Detyrime tatimore

Detyrimet tatimore më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 paraqiten si më poshtë:

	31/12/2020	31/12/2019
Tatim mbi te ardhurat personale	227,482	361,349
Tatim fitimi	-	447,712
Tatim mbi vleren e shtuar (TVSH)	-	2,669,282
Tatim ne burim	-	17,191
Totali	227,482	1,003,334

15. Detyrime Afatgjata ndaj institucioneve të kredisë:

Detyrime afatgjata ndaj institucioneve te kredise me 31 Dhjetor 2020 dhe 2019 janë të përbëra si më poshtë:

	31/12/2020	31/12/2019
Detyrime ndaj intitucioneve të kredisë	6,514,139	-
Totali	6,514,139	-

I.T.E ENGINEERING SH.P.K*(Vlerat në Lekë)***16. Të ardhurat nga shitja**

Shitjet neto 31 Dhjetor 2020 dhe 2019 janë të përbëra si më poshtë:

Te ardhura	31/12/2020	31/12/2019
Shitje e mallrave, punimeve dhe e sherbimeve	446,669,280	496,986,813
Totali	446,669,280	496,986,813

17. Të ardhurat te tjera te shfrytezimit

Te ardhura te tjera te shfrytezimit ne 31 Dhjetor 2020 dhe 2019 janë të përbëra si më poshtë:

	31/12/2020	31/12/2019
Shitje e AAGJ materiale	1,214,295	45,833
Te ardhura nga interesa te faturuar	285,978	
Totali	1,500,273	45,833

18. Materiale dhe sherbime te konsumuara

Materiale dhe Sherbime te konsumuara më 31 Dhjetor 2020 dhe 2019 janë të përbëra si më poshtë:

	31/12/2020	31/12/2019
Blerje mallra, sherbime	369,163,795	415,747,125
Totali	369,163,795	415,747,125

19. Shpenzime personeli

Shpenzimet e personelit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 paraqiten si më poshtë:

	31/12/2020	31/12/2019
--	-------------------	-------------------

I.T.E ENGINEERING SH.P.K*(Vlerat në Lekë)*

Shpenzime per pagat	39,492,393	35,891,554
Shpenz.per sigurimet shoq&shendet	6,380,610	5,728,107
Totali	45,873,003	41,619,661

20. Zhvleresimi i aktiveve afatgjata materiale

Zhvleresimi i aktiveve afatgjata materiale më 31 Dhjetor 2020 dhe 2019 paraqiten si më poshtë:

	31/12/2020	31/12/2019
Zhvleresim i AAGJ materiale	-	13,197
Totali	-	13,197

21. Shpenzime të tjera të shfrytëzimit

Shpenzime të tjera për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 janë si më poshtë:

	31/12/2020	31/12/2019
Qira	1,584,679	1,644,291
Mirembajtje dhe riparime	695,638	947,911
Shpenzime kancelarie	143,741	297,327
Shpenzime konsulence	200,000	180,000
Shpenzime noteriale	14,700	52,900
Publicitet dhe reklama	144,736	147,224
Shpenzime transporti	3,459,830	3,062,588
Shpz.postare e telekom	271,377	292,584
Taksa qarkullimi mjete dhe siguracione	294,632	325,476
Taksa dhe tarifa vendore	187,100	101,000
Vlera kontabel e AQ te shitura	1,109,225	191,623
Shpenzime per koncesione,patenta,licenca	316,208	369,500
Shpenzime per pritje, perfaqesime	660,636	368,355
Transferime, udhetim,dieta	775,500	586,500
Shpenzime te tjera	1,748,111	2,801,384
Totali	11,606,113	11,368,663

22. Shpenzime interesi dhe shpenzime te ngjashme

Shpenzime interesi më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 paraqiten si më poshtë:

I.T.E ENGINEERING SH.P.K*(Vlerat në Lekë)*

	<u>31/12/2020</u>	<u>31/12/2019</u>
Shpenzime interesi	564,920	-
Totali	<u>564,920</u>	<u>-</u>

23. Shpenzime te tjera financiare

Shpenzime te tjera financiare më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 paraqiten si më poshtë:

	<u>31/12/2020</u>	<u>31/12/2019</u>
Fitim nga kembimet valutore	(395,810)	(872,595)
Humbje nga kembimet valutore	479,050	1,559,730
Sherbime bankare	962,097	314,791
Totali	<u>1,045,337</u>	<u>1,001,926</u>

24. Tatimi mbi fitimin

Shoqëria është subjekt i tatimit mbi fitimin në Shqipëri.

Tatimi mbi fitimin është i pagueshëm në normën 15% bazuar mbi fitimin neto për periudhën dhe nuk korrighohen për efekte tatimore në përputhje me legjislacionin shqiptar tatimor. Deklarimi dhe pagesa e detyrimit të tatimit mbi fitimin bëhet cdo vit pranë autoriteteve tatimore, por fitimi dhe humbja fiskale mbeten të përlogaritura derisa të kontrollohen nga këto autoritetet tatimore.

	<u>31/12/2020</u>	<u>31/12/2019</u>
Fitimi (humbja) para tatimit	17,065,870	24,866,864
Shpenzime te panjohura si me poshte:	562,132	1,183,696
Shpenzime per pritje, perfaqesime	556,136	556,136
Penalitete, gjoba e demshperblime	-	-
Shpenz. te tjera pa dok. tat. te rregullta	1,611	769,221
Shpenz. c'regjistrim aset	4,385	145,790
Dhurata	-	-
Shpenzime pertej limiteve te lejuara	-	-

I.T.E ENGINEERING SH.P.K*(Vlerat në Lekë)*

Humbje nga mosarketimet e klienteve	-	-
Fitimi fiskal	17,628,002	26,050,560
Humbje fiskale e mbartur	-	-
Shpenzimet per Tatim Fitimin (15%)	2,644,200	3,907,584

25. Angazhime e detyrime te mundshme

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta. Bazuar në opinionin e drejtuesve të shoqërisë, konkluzioni përfundimtar në lidhje me këto çështje nuk do të ketë efekt negativ në pozicionin financiar të shoqërisë ose ndryshime në aktivet neto të saj.

Më 31 Dhjetor 2020 shoqëria nuk ka angazhime kapitale e detyrime te mundshme qe kerkojne paraqitje ne pasqyrat financiare.

26. Ngjarjet pas datës së bilancit

Asnjë ngjarje e rëndësishme e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare nuk ka ndodhur pas datës së miratimit të pasqyrave financiare.